

Eppc Kosovo kërkon një Praktikant/e me mundësi punësimi për klientin e saj, një organizatë jo-fitimprurëse që operojnë në sektorin e mikrofinancës, që përveç të tjerash synon të vë në pah rolin e mikrofinancës në ekonominë vendore, si dhe performon aktivitete të tjera shërbyese në mbështetje të bizneseve dhe institucioneve mikrofinanciare.

## Përgjegjësitë Kryesore:

1. Mbajtjen e sistemeve financiare ekzistuese duke përfshirë të dhënat për shpenzimet dhe të ardhurat, si dhe të përgatisë raportin e plotë mujor financiar dhe harmonizimin mujor bankar;
2. Procesimin e faturave dhe pagesave dhe verifikimin nëse transaksionet janë në përputhshmëri me politikën dhe procedurat financiare;
3. Mirëmbajtjen dhe përditësimin e të dhënave të kompanisë si: kontaktet, kontratat, të dhënat e trajnimit të pjesëmarrësve dhe dosjet;
4. Organizimin e axhendës për përfaqësuesit e kompanisë;
5. Përmbledhjen e raporteve mujore nga Anëtarët e kompanisë dhe intergrimin në raportin e konsoliduar.

## Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë universitare apo student/e i /e vitit të fundit në Fakultetin Ekonomik;
- I/e përkushtuar dhe i/e motivuar të jap kontribut dhe të mësoj më shumë për mikrofinancën;
- Njohuri të mira të gjuhës angleze;
- Aftësi shumë të mira të komunikimit, relacioneve me njerëz dhe prezantimit;
- Aftësi shumë të mira kompjuterike, analiza kuantitative dhe aftësi në zgjedhje të problemeve;

## Të dhënat:

<b>Pozicioni:</b>	Praktikant/e me pagesë (2-6 muaj);
<b>Vendndodhja:</b>	Prishtinë;
<b>Kontrata:</b>	Sipas Ligjit të Punës;
<b>Aplikimet mbyllen:</b>	19.10.2018.

## Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke përmendur pozicionin **'Praktikant/e'** në subject në adresën e e-mail<sup>-it</sup>:

[kosovo@eppc.al](mailto:kosovo@eppc.al)

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen. Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.